




---

**RAPORTI I GJASHTË NGA  
MONITORIMI I INFORMIMIT  
MEDIATIK PËR PUNËN E KUVENDIT**

---



**KUVENDI NËN THJERRËZ**

**Përforcimi i debatit politik  
dhe diskursit deliberativ**

JANAR 2015



## **RAPORTI I GJASHTË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVENDIN (JANAR 2015)**

Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin nivelin e cilësisë së debatit në Kuvendin dhe raportimin e medieve nga puna e deputetëve. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatik. Para jush është raporti i gjashtë i tillë i cili ka të bëjë me debatin kuvendor në muajin janar 2015.

Me aplikimin e “Indeksit për cilësi të debatit”<sup>1</sup> sipas disa parametrave vlerësohet çdo fjalim i veçantë i pjesëmarrësve në seancat plenare dhe seancat e tetë komisioneve kuvendore të përzgjedhura sipas rëndësisë së tyre për debatin politik dhe kulturën politike në shtetin.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike, të fitohen njohuri se sa janë të argumentuara diskutimet në shtëpinë ligjvënëse dhe se sa qëndrimet e ndryshme merren parasysh dhe kontribuojnë në krijimin e ligjeve.

Në të njëjtën kohë, në kuadër të projektit realizohet edhe monitorimi i disa medimeve kombëtare<sup>2</sup> për tu parë se në çfarë mase opinioni është i njoftuar me esencën e debateve kuvendore dhe me përmbajtjen e argumenteve të shfaqura në seancat nga ana e deputetëve.

Pas çdo muaji të monitoruar opinioni do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe nga monitorimi i debatit në Kuvendin dhe të informimit mediatik.

<sup>1</sup> Indeksi për cilësi të debatit (Discourse Quality Index) është i krijuar nga një grup i teoricienëve prijës botëror demokracisë deliberative (debatuese). Indeksi paraqet metodologji e cila mundëson hulumtim empirik të cilësisë së debateve, forma dhe përmbajtja e të cilave, sipas teoricienëve, janë jashtëzakonisht të rëndësishme për demokracinë në një shoqëri. Indeksi gjatë viteve të fundit është përdorur për hulumtim të debatit në Parlamentin Evropian edhe në parlamentet e Gjermanisë, Zvicrës dhe në Kongresin amerikan.

<sup>2</sup> Monitorimi i medieve i përfshin televizionet kombëtare Sitel, Tellma, Alsat-M dhe RTM2 në gjuhën shqipe dhe gazetatat Dnevnik, Sloboden pečat, Utrinski vesnik, Večer, Koha dhe Lajm.

Projekt: Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ.

Projekti është i financuar nga Unioni Evropian



## A. REZYME

Deputetët në janar më së paku deri tani i arsyetonin pozitat e veta me dy ose më tepër argumente, e më shpesh se deri tani në fjalimet shfaqën nga një argument.

Në këtë periudhë ata sërish nuk arritën të ç'bindin njëri –tjetrin në arsyen e argumenteve të veta dhe çdo njëri mbeti në "istikamin" e vet. Në janar nuk është vërejtur që ndonjë deputet ta ndryshojë pozitën e vet për shkak të argumenteve më cilësore të shfaqura në debatin ose për shkaqe të tjera. Në të njëjtën kohë, me atë deputetët nuk shfaqën interes dhe gatishmëri për ndryshim të qëndrimeve të veta për shkak të argumenteve më cilësore të shfaqura në debatin.

Në këtë periudhë u rrit përqindja e diskutimeve në të cilat shfaqet respekt ndaj deputetëve të tjerë dhe argumentet e tyre.

Deputetët në janar ishin më aktiv në seancën për pyetje të deputetëve dhe në debatet rreth ndryshimeve të ligjeve për arsim të lartë, për planifikim hapësinor dhe urbanistik dhe për nëpunësit administrativ.

Opozita në janar e prezantuar me 10 deputetë, sërish e rriti pjesëmarrjen në diskutimet dhe arriti deri tani nivel më të lartë prej 29%.

Një pjesë e madhe e pikave të rendit të ditës kaluan me diskutim të paktë dhe të njëanshëm ose pa kurrfarë diskutimi.

Me tërë këtë konkluzë është se opinioni sërish mbeti më i varfër me debat më cilësor për një pjesë të zgjidhjeve ligjore. Në këtë mënyrë është shmangur mundësia që përmes diskutimit të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të prezantuara të deputetëve si dhe mundësia që ato të kontestohen ose të plotësohen, gjë e cila do të kishte kontribuar për miratimin e ligjeve më cilësore në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.

## B. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

"Indeksi i cilësisë së debatit" mundëson që çdo debat i veçantë i shfaqur në seancat të kodifikohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- shkalla e argumentimit të fjalimit<sup>3</sup>;
- shkalla i respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;

---

<sup>3</sup>Nën shkallë të argumentimit merren parasysh numri i argumenteve me të cilat deputeti në fjalimin e tij i arsyeton pozicionet e veta duke mos hyrë me këtë rast në vërtetësinë ose vlefshmërinë e argumenteve. Me këtë rast nuk merren parasysh argumentet të cilat në mënyrë të qartë dhe pa dyshim janë nga tema e debatit.

Projekt: Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ.

Projekti është i financuar nga Unioni Evropian



- çiltërsia për pranim të argumenteve të huaja dhe ndryshim të qëndrimeve të veta nën fuqinë e argumenteve të prezantuara në debatin;
- nëse deputetët arsyetojnë se në emër të kujt dhe interesat e kujt i prezantojnë qëndrimet e veta;
- nëse deputetët mund pa pengesa ti shfaqin qëndrimet e veta dhe
- në çfarë mase është i pranishëm fjalori i pahijshëm.

Me monitorimin janë përfshirë debatet në trupat vijuese punuese në Kuvend:

- Seanca plenare;
- Komisioni për çështje kushtetuese;
- Komisioni për financa dhe buxhet;
- Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive;
- Komisioni për zgjedhje dhe emërimet;
- Komisioni për vetëqeverisje lokale;
- Komisioni për çështje evropiane;
- Komisioni anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit;
- Komisioni ligjvënës juridik.

## V. KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill 2014, partia Organizata e brendshme maqedonase revolucionare – Partia demokratike për unitet kombëtar maqedonas (OBMR-PDUK ose VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin ata e themeluan qeverinë, Bashkimi demokratik për integrim (BDI ose DUI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë të Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (NDP). Deputeti i cili mandatin e morri nga RDK edhe përkundër vendimit të partisë që ta bojkotojë

Kuvendin ju bashkëngjit grupit të deputetëve të BDI-së. Me atë tani grupi parlamentar i BDI-së numëron 20 deputetë.

Nga fillimi i monitorimit deri në botimin e raportit të parë, deputetët nga koalicioni më i madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM ose SDSM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotojnë punën e Kuvendit<sup>4</sup>. Në muajin janar në Kuvendin si

---

<sup>4</sup>Deputetët opozitare Roza Topuzovska Ka revska nga Partia Li berale demokratike, Sollza Gërçeva dhe Lubica Buralieva nga LSDM vendosën ti pranojnë mandatet e deputetit të fituara në zgjedhje edhe përkundër vendimit të koalicionit opozitar për bojkot të punës së Kuvendit.




opozitë vepronin tre deputetë nga koalicionin opozitar të LSDM të cilët vendosën që ti pranojnë mandatet dhe shtatë deputetë të Partisë demokratike shqiptare (PDSH). Shumica në parlament e vazhdoi procedurën për marrje të mandateve të 31 deputetëve opozitar të cilët e bojkotojnë parlamentin, ndërsa procedura për të cilën është e nevojshme shumicë prej dy të tretat për vendimmarrje (82 deputetë), nuk përfundoi as në muajin janar.

## G. GJETJE NGA MONITORIMI


Ky raport e përfshin debatin në Kuvend në periudhën nga 1 deri më 31 janar të vitit 2015. Janë analizuar gjithsej 305 fjalime të pjesëmarrësve të debateve në gjithsej 11 seanca nga të cilat 7 janë plenare dhe 4 janë të trupave punuese. Nga seancat e trupave punuese janë përcjellë nga një seancë e Komisionit për çështje kushtetuese, Komisionit për sistem politik dhe raporte midis bashkësive, Komisionit për financim dhe buxhet dhe Komisionit ligdhënës-juridik.

Nga numri i tërësishëm i fjalimeve të monitoruara, 288 janë të deputetëve në Kuvendin, ndërsa 66 të pjesëmarrësve të jashtëm si ministra, përfaqësues të ministrive, institucione të tjera shtetërore dhe publike. Ky raport ka të bëjë vetëm me fjalimet e deputetëve.




### Në raport me karakteristikat demografike të folësve, sipas:


- Seksit: 51% janë burra, ndërsa 49% gra.
- Përkatësisë etnike: 80% janë Maqedonas etnik, 16% Shqiptarë etnik, 4% janë të tjerë.
- Arsimit: 67% janë me arsim të lartë, 23% magjistra 9% doktorë të shkencave.
- Në janar më aktiv ishin deputetët nga njësia e katërt zgjedhore, ndërsa më pak diskutime kishin deputetët nga njësia e dytë zgjedhore.




Në janar deputetët opozitar e rritën pjesëmarrjen në diskutimet dhe arritën pjesëmarrje prej 29% në diskutimet që deri tani është niveli më i lartë që nga fillimi i monitorimit. Kjo është për 8% më tepër se sa në dy muajt (dhjetor dhe tetor) kur u shënuar pjesëmarrja më e lartë e deputetëve opozitar në diskutimet – 21%.



Në seancat e monitoruara që u mbajtën në janar në deputetët burra shkojnë 51% nga numri i tërësishëm i diskutimeve. Në deputetët gra shkojnë 49% të diskutimeve. Me këtë rast, duhet marrë parasysh se deputetet (të gjinisë femërore) janë 35% nga numri i tërësishëm i deputetëve në përbërjen aktuale të Kuvendit. Nga kjo rezulton se gratë më shpesh kanë marrë fjalë se sa burrat.




Nëse koha e tërësishme e diskutimeve pjesëtohet sipas seksit të deputetëve të cilët e kanë marrë fjalën në seancat e monitoruara rezulton se çdo diskutim i deputetëve burra mesatarisht ka zgjatur nga 5 minuta, ndërsa çdo diskutim të deputetëve gra mesatarisht ka zgjatur nga 4 minuta.



Sipas pjesëmarrjes, nëse koha e tërësishme e diskutimeve pjesëtohet në numrin e tërësishëm të mandateve të pranuar rezulton se mesatarisht çdo deputet nga shumica (82 deputetë) ka folur nga 10, ndërsa çdo deputet nga opozita (10 deputetë) ka folur nga 23 minuta. Nëse koha e tërësishme e diskutimeve pjesëtohet vetëm në deputetët të cilat e kanë marrë fjalën në seancat e monitoruara rezulton se çdo diskutim i bërë nga deputetët opozitar mesatarisht ka zgjatur nga 3 minuta, ndërsa nga deputetët e shumicës mesatarisht nga 5 minuta.




## Kohëzgjatje mesatare e diskutimeve (e shprehur në minuta)



### I. LLOJ I FJALIMIT DHE INTERAKSIONI

Monitorimi në janar tregoi interaksion pothuajse identik midis deputetëve vëzhguar sipas numrit të replikave dhe kundër-replikave midis pjesëmarrësve në debatet krahasuar me muajin paraprak. Me këtë rast, si replika dhe kundër-replika janë vërejtur edhe pyetjet dhe përgjigjet midis deputetëve dhe ministrave në seancën plenare që u kushtohet pyetjeve të deputetëve. Në seancat e monitoruara në diskutime individuale shkojnë 66%, në replika 16%, ndërsa në kundër-replika 18% të diskutimeve. Në krahasim me muajin paraprak (dhjetor) ka rritje minimale prej 1% të diskutimeve individuale, ndërsa zvogëlim minimal prej 1% në pjesën e replikave. Nëse shihet e tërë periudha nga fillimi i monitorimit, bashkë me dhjetorin, përqindja e kundër-replikave është më e lartë. Përqindja e replikave ka qenë më e lartë në tetor dhe në dhjetor.




Në janar në seancat e monitoruara deputetët burra kanë dhënë 53% të diskutimeve individuale, 53% të replikave dhe 35% nga kundër-replikat. Deputetët gra, ndërkaq, dhanë 47% të diskutimeve individuale dhe 65% të kundër-replikave.






## Pjesëmarrje në diskutimet sipas seksit të deputetëve



## II. SHKALLË E ARGUMENTIMIT TË FJALIMIT

Nga fjalimet e monitoruara të deputetëve sipas Indeksit për cilësi të debatit, në 44% ekziston arsyetim i pozitave me dy ose më tepër argumente. Në 43% të fjalimeve deputetët i arsyetuan pozitën e veta me një argument. Në 12% argumentimi ka qenë i dobët përkatësisht arsyetimi që e ka dhënë folësi nuk ka mjaftuar të konsiderohet për një argument të plotë. Në 1% nuk është prezantuar kurrfarë argumenti në diskutimin. Marrë në përgjithësi, në janar shkalla e argumentimit me më së paku dy argumente është më e ulët deri tani që nga fillimi i monitorimit (në qershor). Diskutimet në të cilat deputetët në fjalimet e veta kanë përdorur një argument, në janar arrijnë 43% që është niveli më i lartë që nga fillimi i monitorimit. Përqindja e diskutimeve pa argumente ka rënë në 1% që gjithashtu është më e ulët deri tani. Në 12% nga fjalimet deputetët kanë pasur arsyetim të dobët përkatësisht në diskutimin nuk ka mundur të përcaktohet një argument i plotë.


## Vallë nëse dhe sa argumente shfrytëzohen në fjalimin? (%)





### III. FUQIA E ARGUMENTIT MË TË MIRË

Në seancat e monitoruara në janar, ashtu si edhe në periudhat paraprahe, asnjë folës nuk ka vënë në pah se e ndryshon pozitën e vet për shkak të argumenteve më të mira të shfaqura në debatin, ose për shkaqe të tjera. Ndryshimi i këtillë i pozicionit është vërejtur vetëm në periudhën e parë të monitoruar (19 qershor – 1 gusht). Krahasuar me dhjetorin, për 33% janë zvogëluar diskutimet në të cilat deputetët aspak nuk i vështrojnë argumentet e prezantuara në debatin, ose për shkaqe të tjera. Ndryshimi i këtillë e pozicionit është vërejtur vetëm në periudhën e parë të monitoruar (19 qershor – 1 gusht). Krahasuar me dhjetorin, për 33% janë zvogëluar diskutimet në të cilat deputetët aspak nuk u bëjnë vështrim argumenteve të shfaqura nga pjesëmarrësit e tjerë. Kjo përqindje tani është 50% dhe është më e ulët që nga fillimi i monitorimit nga data 19 qershor. Në janar është mbresëlënëse është që në seancat e monitoruara në 26% të diskutimeve folësit nuk e kanë ndryshuar pozicionin e vet, por prapëseprapë i kanë njohur argumentet e palës tjetër, ndërsa 23% nuk e kanë ndryshuar pozicionin e vet dhe nuk e kanë pranuar vlefshmërinë e argumenteve të huaja. Vërehet se në janar në raport me dhjetorin, ka rritje për 23% të deputetëve të cilët në fjalimet e veta e kanë njohur argumentin e huaj por nuk e ndryshojnë pozicionin e vet. Gjithashtu, ka rritje për 9% të deputetëve të cilët në fjalimet e veta nuk e ndryshojnë pozicionin e vet dhe nuk e pranojnë argumentin e huaj.




### IV. RASPEKTIM NDAJ Pjesëmarrësve

Në janar është shënuar rritje e shfaqjes së respektimit ndaj deputetëve të tjerë, bashkëpjesëmarrës në kuadër të fjalimeve të veta. Kjo rritje është për më tepër se gjysma krahasuar me muajin paraparak (janar 59% - dhjetor 28%). Në mënyrë përkatëse, është vërejtur edhe zvogëlim i përqindjes së folësve të cilët nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti ndaj të pranishmit e tjerë, për pothuajse gjysma nga ajo në muajin dhjetor (janar 32% - dhjetor 62%). Gjithashtu në 6% është rritur edhe përqindja e diskutimeve në të cilat është shfaqur respektim, gjë e cila njëkohësisht është përqindja më e lartë që nga fillimi i monitorimit. Respektimi eksplicit para së gjithash do të thotë se deputetët në diskutimet e veta kanë drejtuar lëvdata personale ose partiake ndaj pjesëmarrësve të tjerë të seancave. Njëkohësisht, shkalla e respektimit të ndërsjellë është zvogëluar në 4%, gjë e cila është më pak se sa në dhjetor. Respektim të pjesshëm do të thotë se deputetët në diskutimet ndaj argumenteve të tjerëve në pjesën më të




madhe kanë qenë neutral ose kanë shfaqur respektim. Ashtu si edhe në muajin e kaluar, në janar nuk është vërejtur asnjë rast të mos-respektimit të plotë ose të pjesshëm ndaj pjesëmarrësve të tjerë.




## V. RESPEKTIM NDAJ ARGUMENTEVE

Në janar deputetët në mënyrë të shumëfishtë e rritën shfaqjen e respektit ndaj argumenteve të folësve të tjerë. Atë e bënë në 56% të diskutimeve krahasuar me dhjetorin kur ndodhi që vetëm në 8% të diskutimeve. Prapëseprapë ky nuk është niveli më i lartë. Në periudhën 19 qershor – 1 gusht deputetët shfaqën respektim ndaj argumenteve të folësve të tjerë në 74%, ndërsa në periudhën 25 gusht – 30 shtator në 61% të diskutimeve. Në janar për më tepër se dyfish u zvogëlua përqindja e fjalimeve në të cilat deputetët nuk shfaqnin kurrfarë raporti ndaj argumenteve të diskutuesve të tjerë. Kjo përqindje në janar është 40%, krahasuar me 85% në dhjetor, 80% në nëntor dhe 68% në tetor. Kjo është më tepër se nga dy periudhat e para të monitoruara, 19 qershor – 1 gusht (20%) dhe 25 gusht – 30 shtator (30%).



## VI. VËLLIMI I ARESYETIMEVE DHE I NDËRPRERJEVE

Në janar, në 31% të diskutimeve, pjesëmarrësit ishin neutral, përkatësisht nuk i ndërlidhën argumentet e veta me përfitimet ose pasojat për ndonjë grup ose parti. Ky është ndryshimi më i madh krahasuar me dy muajt paraprak. Në 52% të diskutimeve deputetët i ndërlidhën argumentet e veta me përfitimet ose pasojat për të mirat e të gjithë qytetarëve përkatësisht me të mirën e përgjithshme. Monitorimi në janar tregoi rënie të përqindjes së diskutimeve në të cilat folësit thirren në përfitime ose pasoja për grupet e veta partiake ose etnike. Kjo përqindje në janar është 8%, krahasuar me 29% në dhjetor dhe 39% në nëntor.





## VII. GJUHA E PAHIJSHME

Në pikëpamje të gjuhës së pahijshme, pjesëmarrësit në debatet e monitoruara kuvendore në këtë periudhë në përgjithësi përmbaheshin nga përdorimi i saj. Në janar, në seancat e monitoruara nuk është vërejtur që ndonjë diskutues të shfrytëzojë gjuhë të pahijshme, e as është vërejtur rast të kufizimit të deputetëve gjatë fjalimeve të tyre nga foltoret.

### D. KONKLUZIONE:

- Për 19% u zvogëluan diskutimet në të cilat deputetët qëndrimet i mbështesin me dy dhe më tepër argumente, ndërsa u rrit përqindja e diskutimeve me një argument. Shkalla e argumentimit të fjalimeve me më së paku dy argumente në janar pësoi rënie në nivel më të ulët që nga fillimi i monitorimit.
- Pjesëmarrësit në seancat e monitoruara sërish nuk shfaqën interesim dhe gatishmëri për ndryshimin e qëndrimeve për shkak të argumenteve më cilësore të prezantuara në debatin. Asnjë deputet nuk e ka vënë në pah ndryshimin e pozitës së vet pa marrë parasysh se në 26% nga rastet folësit e kanë pranuar vlefshmërinë e argumenteve të prezantuara.
- Vazhdoi trendi i zvogëlimit të përqindjes së diskutimeve në të cilat folësit aspak nuk u bëjnë vështrim argumenteve të shfaqura nga folës të tjerë. Në nëntor ishte 99%, në dhjetor 83%, ndërsa në janar 50%.
- Opozita në Kuvend e përfaqësuar nga 10 deputetë e rriti pjesëmarrjen në diskutimet në nivel deri tani më të lartë prej 29%. Niveli më i lartë i pjesëmarrjes deri tani ishte në tetor dhe dhjetor kur ishte në 21%.
- Në janar është monitoruar seanca e Komisionit ligjdhënës-juridik në të cilën për 15 pika të rendit të ditës asnjë deputet nuk e ka marrë fjalën.
- Sipas seksit të diskutuesve të burrat shkojnë 51% nga numri i përgjithshëm i diskutimeve, ndërsa të gratë shkojnë 49%. Prej këto diskutime burrat kanë pasur më tepër diskutime individuale dhe replika, ndërsa gratë e kanë bërë pjesën më të madhe të kundër-replikave.
- Në janar sërish u rrit përqindja e diskutimeve në të cilat deputetët kanë shfaqur respekt ndaj deputetëve të tjerë dhe ndaj argumenteve të tyre pas tre muajve të trendit të rënies në shfaqjen e respektit.
- Pyetjet e deputetëve dhe ndryshimet e ligjeve për arsim të lartë, për planifikim hapësinor dhe urbanistik dhe atij për nëpunës administrativ nxitën debat midis deputetëve i cili u pasqyrua me numrin e shtuar të replikave midis pjesëmarrësve në seancat krahasuar me periudhat paraprake të monitoruara (nëntor, periudhat 25 gusht – 30 shtator dhe 19 qershor – 1 gusht). Më tepër replika ka pasur vetëm në tetor ndërsa në dhjetor deputetët kanë pasur më shumë kundër-replika deri tani.



- Diskutimi rreth pjesës më të madhe të propozimeve ligjore mbetet në përgjithësi i dobët dhe nuk mundëson që përmes debatit publik të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të përgatitura dhe të prezantuara të deputetëve. Me atë shmanget mundësia që argumentet të kontestohen ose të plotësohen, dhe me atë opinioni është i varfëruar për pikëpamje të ndryshme të cilat do të kontribuonin për përpilim të vendimeve më cilësore për të mirën e përgjithshme dhe për interesin publik.
- Në këtë periudhë është rritur përqindja e diskutimeve në të cilat diskutuesit kanë qenë neutral përkatësisht nuk i ndërlidhin me përfitimet dhe pasojat për asnjë grup, në nivelin deri tani më të lartë prej 31%. Në llogari të kësaj, deputetët në janar më shpesh argumentet e veta i kanë ndërlidhur me të mirën e përgjithshme krahasuar me dhjetorin, ndërsa është zvogëluar përqindja e diskutimeve në të cilat folësit janë thirrur në parime abstrakte dhe në përfitimet ose pasojat për grupet e veta politike ose etnike.

\*\*\*\*\*

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit publik dhe diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian.